

### Nis puna për hartimin e strategjisë për zhvillimin e tregut të kapitalit në Shqipëri

### Vështrim mbi tregjet

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri, janar-gusht 2020

### Zhvillime të tjera

- AMF nxjerr për konsultim publik projektregullore për tregjet nën mbikëqyrje
- Takim *online* mes Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv të AMF-së dhe Drejtueses së Misionit të FMN-së për Shqipërinë
- Miratohen kushtet e kontratës së sigurimit të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri

### Botime Profesionale

- BIS
- Financial Times
- IOPS
- IOSCO
- “Revista mbi Menaxhimin e Riskut në Institucionet Financiare” - titujt kryesorë

### Informacione Ndërkombëtare

- Greqi
- Hungari
- Kosovë
- Kroaci
- Mali i Zi
- Slloveni
- Turqi

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

## Nis puna për hartimin e strategjisë për zhvillimin e tregut të kapitalit në Shqipëri

Nis punën grupi i përbashkët “Për hartimin e strategjisë për zhvillimin e tregut të kapitaleve”, me pjesëmarrjen e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Grupi i punës do të analizojë situatën aktuale të tregut të kapitaleve dhe do të hartojë një dokument strategjik 5-vjeçar, shoqëruar me një plan konkret veprimi, për përmbushjen e hapave të nevojshme për zhvillimin e tregut të kapitaleve.

Në funksion të përgatitjes së dokumentit strategjik, grupi i punës do të analizojë gjithashtu infrastrukturën ekzistuese të tregut të kapitaleve dhe kapacitetet e saj për të përballuar dinamikën e zhvillimit të këtij tregu.

Në planin e veprimit do të përcaktohen hapat për listimin në Bursë të shoqërive me kapital shtetëror. Ky plan veprimi parashikohet të hartohet brenda datës 30 nëntor 2020.

Pjesë e diskutimeve për hartimin e dokumentit strategjik do të jenë edhe përfaqësues nga subjektet e tregut të kapitalit, si edhe nga institucione, shoqata apo shoqëri të tjera private, që mund të japin kontribut në zhvillimin e këtij tregu.

---

Grupi i punës do të analizojë situatën aktuale të tregut të kapitaleve dhe do të hartojë një dokument strategjik 5-vjeçar, shoqëruar me një plan konkret veprimi, për përmbushjen e hapave të nevojshme për zhvillimin e tregut të kapitaleve.

# VËSHTRIM MBI TREGJET


## Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri, janar-gusht 2020

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit në periudhën janar-qershor 2020 arritën vlerën 10,625 milionë lekë, ose 6.48% më pak se në periudhën janar-gusht 2019. Gjatë periudhës janar-gusht 2020, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 609,601 me një ulje prej 30.58% krahasuar me periudhën janar-gusht 2019.


Tregu vazhdoi të mbetet sërish i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 93.43% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, duke i lënë sigurimet e Jetës me 6.56%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 37.79% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 62.21% të totalit të tregut.

Gjatë periudhës janar-gusht 2020, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 4,981 milionë lekë, ose 31.03% më shumë se në periudhën janar-gusht 2019.

Struktura e tregut të sigurimeve, Janar - Gusht 2020



Gjatë periudhës janar-gusht 2020, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 4,981 milionë lekë, ose 31.03% më shumë se në periudhën janar-gusht 2019.



## AMF nxjerr për konsultim publik disa projektregullore për tregjet nën mbikëqyrje

- ❑ Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në zbatim të Ligjit nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit”, ka hartuar projektregulloren **“Për licencimin e shoqërisë komisionere, regjistrimin e degës së shoqërisë së huaj komisionere dhe njohjen e shoqërisë së huaj komisionere”**. Projektregullorja dhe shtojcat përkatëse publikohen në faqen zyrtare të Autoritetit, për konsultim publik, në linkun:

<https://amf.gov.al/projekt.asp?id=50>

- ❑ AMF ka hartuar projektregulloren **“Për procedurën e certifikimit dhe kualifikimet e punonjësve me funksione kyçe të shoqërisë komisionere”**. Projektregullorja dhe shtojcat përkatëse publikohen në faqen zyrtare të Autoritetit, për konsultim publik, në linkun:

<https://amf.gov.al/projekt.asp?id=51>

- ❑ AMF ka hartuar projektregulloren **“Për formatin e pyetësorit të vlerësimit të përshtatshmërisë së klientit”**. Projektregullorja dhe shtojcat përkatëse publikohen në faqen zyrtare të Autoritetit, për konsultim publik, në linkun:

<https://amf.gov.al/projekt.asp?id=53>

- ❑ Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në zbatim të Ligjit nr. 56/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”, ka hartuar projektregulloren **“Për formën, llogaritjen dhe shumën e fondeve të veta që duhet të ketë detyrimisht shoqëria administruese e fondeve”**. Projektregullorja publikohet në faqen zyrtare të Autoritetit, për konsultim publik, në linkun:

<https://amf.gov.al/projekt.asp?id=52>

AMF nxjerr për konsultim publik projektregullore të rëndësishme për tregun e kapitalit dhe sipërmarrjet e investimeve kolektive.

## Takim *online* mes Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv të AMF-së dhe Drejtueses së Misionit të FMN-së për Shqipërinë



24 shtator 2020 – Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, Z. Ervin Mete, në takim *online* me Drejtuesen e Misionit të FMN-së në Shqipëri

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv e njohu Drejtuesen e Misionit të FMN-së për Shqipërinë me masat konkrete të Autoritetit në funksion të garantimit të qëndrueshmërisë së tregjeve dhe përshtatjes së planeve të vazhdimësisë së biznesit.

Ndikimi i pandemisë COVID-19 në tregjet nën mbikëqyrje dhe masat e marra nga Autoriteti ishin në qendër të takimit virtual mes Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv të AMF-së, z. Ervin Mete dhe Drejtueses së Misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar për Shqipërinë, znj. Yan Sun.

Z. Mete u shpreh se në përgjithësi tregjet nën mbikëqyrjen e Autoritetit i rezistuan efekteve të pandemisë, megjithatë AMF po ushtron një monitorim të kujdesshëm për shkak të pasojave vazhduese.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv e njohu Drejtuesen e Misionit të FMN-së për Shqipërinë me masat konkrete të Autoritetit në funksion të garantimit të qëndrueshmërisë së tregjeve dhe përshtatjes së planeve të vazhdimësisë së biznesit. Gjithashtu, Z. Mete e informoi Znj. Yan Sun në lidhje me procesin e trajtimit dhe pagesave të dëmeve të tërmeteve të vitit të kaluar nga shoqëritë e sigurimit.

Duke pasqyruar ecurinë e tregjeve nën mbikëqyrje, Z. Mete deklaroi se tregu i sigurimeve ka pasur një trend pozitiv rikuperimi. Tregu i fondeve të investimeve dhe pensioneve private vullnetare paraqitet i qëndrueshëm.

Në takim u diskutua edhe për zhvillimet makroekonomike në vend dhe ndikimet e mundshme në tregjet financiare nën mbikëqyrjen e Autoritetit. Në terma më të gjerë, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së dhe Drejtuesja e Misionit të FMN-së biseduan për masat e mundshme të menaxhimit të rrezikut nga ngjarjet e jashtëzakonshme dhe situatat e krizave.

Nga ana e saj, znj. Yan Sun vlerësoi rolin mbikëqyrës të Autoritetit në këtë periudhë të vështirë për tregjet financiare, si edhe shprehu gadishmërinë për të asistuar në vijimësi Autoritetin përmes ekspertizës teknike ndërkombëtare.

## AMF miraton kushtet e kontratës së sigurimit të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri


Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare miratoi në mbledhjen e datës 31.08.2020 kushtet standarde të kontratës së sigurimit të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin.

Kontrata e sigurimit mbulon ngjarjet aksidentale gjatë kryerjes së shërbimit operacional, ku përfshihet vdekja si rezultat i aksidentit, paaftësi e përhershme ose e përkohshme si rezultat i një aksidenti ose sëmundjeje gjatë shërbimit, si edhe shërbimet spitalore dhe mjekësore në spitalet publike në vend, ose jashtë vendit në rastet kur ato nuk ofrohen.

Kontrata e sigurimit realizohet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe tarifa e primit të sigurimit nuk mund të jetë më e vogël se 0.5% e shumës së siguruar. Dëmshpërblimi për personat e siguruar është në varësi të shkallës së dëmtimit apo sëmundjes dhe mund të arrijë deri në 5 milionë lekë.

Në kushtet e miratuara përfshihet edhe tabela e koeficientëve të përfitimit ndaj dëmtimeve trupore, ku përcaktohen rastet për përfitimin e pagueshëm në përqindje ndaj shumës së sigurimit. Gjithashtu, në kushtet e kontratës është specifikuar procedura e dëmshpërblimit, që nga njoftimi i ngjarjes së sigurimit, trajtimi dhe pagesa e përfitimit.


Në kushtet e kontratës është specifikuar procedura e dëmshpërblimit, që nga njoftimi i ngjarjes së sigurimit, trajtimi dhe pagesa e përfitimit



## BIS Quarterly Review, September 2020

This *Quarterly Review* looks at the financial market's recovery from March's acute stress, noting that the upturn has been uneven and corporate balance sheets remain fragile. It also analyses how lower interest rates affect stock prices and explores why equity investors have been negative towards banks even though they entered the pandemic well positioned to absorb losses thanks to post-2008 regulatory reforms.

BIS Quarterly Review | 14 September 2020  
PDF full text (1.360kb) | 119 pages



Markets rise despite subdued recovery



Links between banks and non-banks

## Buletini tremujor i BIS, shtator 2020 BIS Quarterly Review, September 2020

Më poshtë janë dy ndër shkrimet e këtij numri:

### Lidhjet ndërkufitare midis bankave dhe institucioneve financiare jobankare

*Cross-border links between banks and non-bank financial institutions*  
[https://www.bis.org/publ/qtrpdf/r\\_qt2009e.htm](https://www.bis.org/publ/qtrpdf/r_qt2009e.htm)

Abstrakt:

Lidhjet ndërkufitare midis bankave dhe institucioneve financiare jobankare dolën më shumë në pah vitet e fundit. Qendrat financiare dhe ekonomitë e vendeve të mëdha e të përparuara luajnë një rol të rëndësishëm. Po ashtu, edhe vëllimi i lidhjeve ndërkufitare të bankave me institucionet financiare jobankare në ekonomitë e tregjeve në zhvillim ka qenë në rritje, megjithëse duke filluar nga një bazë më e ulët. Trazirat e tregut financiar të shkaktuara nga Covid-19 zbuluan disa dobësi të lidhura me lidhjet ndërkufitare midis bankave dhe institucioneve financiare jobankare.

### Tregjet rriten, pavarësisht se rimëkëmbja ekonomike është ende e dobët

*Markets rise despite subdued economic recovery*  
[https://www.bis.org/publ/qtrpdf/r\\_qt2009a.htm](https://www.bis.org/publ/qtrpdf/r_qt2009a.htm)

Abstrakt:

Tregjet financiare regjistruan fitime të qëndrueshme gjatë periudhës 12 qershor – 7 shtator 2020, pas stresit akut të kaluar në mars të këtij viti. Rritja u ndikua edhe nga politikat monetare dhe fiskale mbështetëse, sidomos në disa ekonomi të përparuara, si edhe me ndalimin e rënies së aktivitetit ekonomik. Megjithatë, zhvillimi ekonomik mbeti jo i plotë dhe i brishtë. Ekspertët bien dakord për parashikimin, se kthimi në ritmet e rritjes dhe tendencat e para krizës nuk ka shumë gjasa të ndodhë shpejt. Kjo ngre pikëpyetje nëse çmimet e aseteve me risk kanë dalë jashtë vëmendjes në vështrimin e përgjithshëm mbi ekonominë.

Buletini "BIS Quarterly Review" është një botim i Banks for International Settlements me periodicitet tremujor. Ai përmbledh artikuj studimorë, shkrime speciale, të dhëna statistikore për tendencat e tregjeve, etj.

Buletini tremujor i BIS, shtator 2020, bën një rishikim të mënyrës se si po riformatohen, ngrihen tregjet financiare pas krizës akute të marsit të këtij viti nga Covid-19, duke vërejtur se si ringritja nuk është kudo e barabartë dhe se ende bilancet e korporatave mbeten në pozicione delikate.



## Financial Times

### Ndikimi Ekonomik i Koronavirusit Kriza pandemike: Treguesit për ringritjen e ekonomisë globale

Gradualisht, Bota po del nga pandemia COVID-19, që solli tkurrjen më të madhe ekonomike globale që prej viteve '30 të shekullit të kaluar. Aktiviteti ekonomik ka filluar të rimëkëmbet në mënyrë të ngadaltë.

Në artikullin e “*Financial Times*” jepen disa tregues alternativë për të pasur një pamje të hershme të ndryshimeve në aktivitetet ekonomike në disa vende të ndryshme dhe nëpërmjet grafikëve, pasqyrohen tendencat dhe jepen tregues mbi ecurinë e ekonomisë.

<https://www.ft.com/content/272354f2-f970-4ae4-a8ae-848c4baf8f4a>



## IOSCO - Java e Investitorit 2020

<https://www.iosco.org/news/pdf/IOSCONEWS575.pdf>

Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Titujve (IOSCO) njoftoi fillimin e përgatitjeve për Javën e Katërt Vjetore të Investitorëve (WIW) nga 5 deri më 11 tetor 2020, siç ishte planifikuar fillimisht, para shpërthimit të pandemisë COVID 19. Faqja *online* e dedikuar “Javës së Investitorit 2020” është [www.worldinvestorweek.org](http://www.worldinvestorweek.org) dhe është në dispozicion për pjesëmarrësit dhe të interesuarit e tjerë.

IOSCO ka vendosur të vijojë me organizimin e aktiviteteve për “Javën e Investitorit 2020” edhe gjatë këtyre kohërave të vështira. Investitorët dhe konsumatorët financiarë në të gjithë botën, tashmë më shumë se më parë, duhet të menaxhojnë financat dhe investimet e tyre në mënyrë efikase si edhe të forcojnë qëndrueshmërinë e tyre financiare përballë pasigurisë në rritje ekonomike.

Secili nga pjesëmarrësit në këtë iniciativë globale, WIW 2020, autoritetet rregullatore, bursat, shoqatat e investitorëve apo shoqëria civile, do të përshtatin aktivitetet e tyre sipas kushteve të vendit dhe nevojave specifike, duke mundësuar edhe zhvillimin e fushatave të tyre informuese, plotësisht në format digjital.

WIW është një fushatë globale e promovuar nga IOSCO për të rritur ndërgjegjësimin në rëndësinë e edukimit dhe mbrojtjes së investitorëve dhe për të nxjerrë në pah iniciativat e ndryshme të rregullatorëve të titujve në këto dy fusha kritike. Fushata ka gjithashtu mbështetjen e organizatës ndërkombëtare G20. Përveç temave kryesore, nga edicionet e kaluara, siç janë investimi në internet, ofertat fillestare të monedhave, bazat e investimit, etj., “Java e investitorit 2020” do të mbulojë edhe çështje *Ed-Tech*, të tilla si mësimi digjital dhe edukimi në internet, të cilat nxisin mundësinë e mësimin në distancë.



**Journal of Risk Management for Financial Institutions**  
**Revista mbi menaxhimin e rrezikut në Institucionet Financiare**

<https://www.henrystewartpublications.com/jrm/v13>

Artikujt kryesorë në volumi 13/2020, numri 3 janë:

**Editorial: Parashikimi i rreziqeve në një botë pandemike**  
Roger G. Chen, Anëtar i Bordit Redaktues

**Menaxhimi efektiv i rreziqeve në një portofol të ESG**

Andre Bertolotti, Shefi i Kërkimit dhe të Dhënave Globale të Qëndrueshme, BlackRock Sustainable Investing

**Kuadri i qeverisjes së rrezikut dhe tre linjat e konstruktit të mbrojtjes: Një proces i vetëvlerësimit i sfiduar përmes një gasjeje të bazuar në aktivitete**

Bradford Hu, Shefi i Riskut dhe Aslihan Denizkurdu, Shefi i Qeverisjes dhe Zyrtari Kryesor i Operacioneve për Menaxhimin e Riskut, Citigroup

**CRDV/CRR II: Një përmbledhje gjithëpërfshirëse e hapit të parë evropian drejt zbatimit të Bazelit IV (Pjesa II)**

Martin Neisen, Partner, PricewaterhouseCoopers  
Hermann Schulte-Mattler, Profesor, Universiteti i Shkencave dhe Arteve të Aplikuara të Dortmund

**Në sytë e vëzhguesit: Perceptimi i rrezikut rregullator kundrejt industrisë**

Meghan E. Burns, Analist i Përgjithshëm i Asociuar,  
Dror Y. Kenett, Ekonomist  
Jonathan S. Sokobin, Krye Ekonomist dhe Zëvendës President i Lartë, Autoriteti Rregullator i Industrisë Financiare, Zyra e Kryeekonomistit

**Modifikimi i praktikës së menaxhimit të rrezikut model në epokën e UA / ML**

Liming Brotcke, Drejtor i Sr - Rreziku i Vlerësimit të Modelit - MRM, Ally

**Mbi përkufizimin e rrezikut**

Filipe Lemos, Menaxher i Rrezikut, Menaxhimi i Rrezikut, BNI Europe

## GREQI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas shifrave paraprake të publikuara nga Shoqata Greke e Shoqërive të Sigurimeve (HAIC), në fund të qershorit 2020, tregu grek i sigurimeve arriti në vlerën e 1.93 miliardë EUR prime të shkruara bruto, me një rënie prej 4.5% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Segmenti i sigurimeve të Jo-Jetës kishte uljen më të vogël, me 0.5% krahasuar me 6-mujorin e parë të vitit 2019, duke arritur në 1.04 miliardë EUR. Kjo erdhi për shkak të normave negative të raportuara nga sigurimet MTPL si edhe nënklasat e sigurimit nga zjarri. Ndërsa segmenti i sigurimit të Jetës u ul me gati 9% duke arritur në 886 milion EUR. Në këtë rënie, ndikimi më i madh ka ardhur nga dinamika negative e raportuar nga policat tradicionale të sigurimit të Jetës, të cilat ranë me -12.8%.

Shifrat e tregut të botuara nga HAIC përfshijnë informacionin për 51 kompani sigurimesh, nga të cilat 19 ishin aktive në sigurimin e Jetës dhe 43 ishin aktive në sigurimin e Jo-Jetës.

## HUNGARI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Banka Qendrore e Hungarisë (MNB) synon të ndryshojë primet e paguara nga klientët në sigurimin motorik MTPL (kgfb në Hungarisht) duke filluar nga 1 janar 2021. Në mes të muajit shtator MNB u bëri thirrje siguresve në vend të rishikojnë tarifat duke marrë parasysh "databazën e kgfb" e cila ka qenë e arritshme për siguresit që prej fillimit të vitit. Banka Qendrore Hungareze pret nga siguresit që primet e MTPL-së të llogariten bazuar në statistikën edhe për ato shoqëri siguri të cilat nuk kanë bazën e tyre individuale të të dhënave, por mund të përdorin atë që MNB ka. Në një njoftim për shtyp të Bankës Qendrore të Hungarisë theksohet se "Baza e të dhënave për sigurimin MTPL në vend, që funksionon pranë saj, ofron një sfond të mjaftueshëm statistikor mbi kontratat, detyrimet, dëmet duke filluar nga viti 2011 për të gjithë aktorët e tregut në mënyrë që të vendosen tarifa të arsyeshme".

Në njoftim thuhet se "Tarifat mjaft të larta të MTPL-së, të cilat janë madje dy deri në tre herë më shumë se tarifa bazë e MTPL, konsiderohen një praktikë e keqe, e pabazuar në statistikën mbi dëmet. Kjo është shkak që ato mund të tejkalojnë llogaritjen e tarifave të bazuara në rrezik dhe mund të ndikojnë në sistemin *Bonus-Malus*".

Kështu, MNB u bëri thirrje siguresve të MTPL të rishikojnë tarifat e tyre dhe, nëse është e nevojshme, t'i ndryshojnë, në mënyrë që ato të jenë në përputhje me parimet e përmendura, duke nisur nga 1 janari 2021. MNB njoftoi se do të fillojë të kontrollojë tarifat e MTPL pas një periudhe gjashtë mujore, nga 1 korrik 2021.

## KOSOVË

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Në mbledhjen e muajit korrik 2020, Bordi Ekzekutiv i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK) vendosi të ulë përkohësisht vlerën e policave të sigurimit kufitar. Ky vendim i marrë nga drejtuesit e BQK-së erdhi pas shqyrtimit të raportit aktuarial të Byrosë së Sigurimeve të Kosovës dhe raportit aktuarial të BQK-së mbi përshtatshmërinë e tarifave të sigurimit kufitar. Nga analizimi i të dhënave aktuariale u vlerësua se ekziston baza për të ndryshuar normat e primit të sigurimit kufitar të përgjegjësive motorike për automjetet e pasagjerëve dhe motoçikletat.

Përmes këtij vendimi, BQK kërkon nga Byroja e Sigurimeve të Kosovës, që siguruesit e licencuar për sigurimin e detyrueshëm të përgjegjësive motorike, të ulin përkohësisht tarifën e sigurimit kufitar të përgjegjësive motorike me 35%.

Zbatimi i tarifave të reja për policat kufitare do të jetë në fuqi gjatë periudhës 1 gusht - 31 dhjetor 2020.

## KROACI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas statistikave të botuara nga Byroja Kroate e Sigurimeve, vëllimi i primeve të shkruara bruto, për gjysmën e parë të vitit 2020 u ul me 2.3% në bazë vjetore, duke arritur në 5.66 miliardë HRK (749 milionë EUR). Kjo rënie lidhet me primet në tregun e Sigurimeve të Jetës i cili pati një rënie duke arritur në 1.40 miliardë HRK (rreth 185 milionë EUR). Ndërsa primet e shkruara bruto në tregun e sigurimeve të Jo-Jetës u rritën me 3.49% duke arritur në 4.26 miliardë HRK (rreth 564 milionë EUR).

Ndërkohë gjatë Konferencës të Shoqatës Aktuariale të Kroacisë, Znj. Ilijana Jelec, Anëtare e Bordit Drejtues të Agjencisë Mbikëqyrëse të Shërbimeve Financiare Kroate (HANFA) bëri një parashikim mbi ecurinë e tregun kroat të sigurimeve. Gjatë kësaj konference, të mbajtur *online* në datat 17-18 shtator 2020, Znj. Ilijana Jelec, duke iu referuar rënies së prodhimit të brendshëm bruto në vend, theksoi se kjo do të ndikonte edhe në rënien e primeve të shkruara bruto në sigurime, e cila pritet të ulet me – 4.4% në fund të 2020, krahasuar me vitin 2019.

Në tregun kroat të sigurimeve, deri në fund të qershorit 2020, vepronin 18 shoqëri sigurimesh.

## MALI I ZI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Shifrat e tregut të sigurimeve të Malit të Zi të publikuara nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve (ISA), tregojnë se pavarësisht nga pandemia COVID-19, në fund të qershorit 2020, tregu vendas mbeti në nivel të ngjashëm me gjysmën e parë të vitit 2019. Vëllimi i primeve të shkruara bruto arriti në 46.50 milionë EUR në fund të qershorit 2020, ndërsa ishte 46.59 milionë EUR në fund të qershorit 2019.

Primet e shkruara bruto nga sigurimet e Jo-Jetës përfaqësonin 80.42% të tregut të sigurimeve në vend me rreth 37.39 milionë EUR, me një rënie prej 3.83% e llogaritur mbi baza vjetore. Ndërsa, sigurimet e Jetës u rritën me 18.08% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke arritur në 9.11 milionë EUR. Sipas shifrave të Autoritetit të Malit të Zi, ISA, uljet më të mëdha të primeve të shkruara bruto u raportuan në linjat e sigurimeve motorike dhe sigurimet e shëndetit.

## SLLOVENI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Për shkak të situatës së pasigurt në lidhje me përhapjen e pandemisë COVID-19 dhe pasojave të paqarta të saj në ekonomi dhe industrinë e sigurimeve, Agjencia Sllovene e Mbikëqyrjes së Sigurimeve rekomandon që kompanitë e sigurimeve, risigurimeve dhe pensioneëve edhe pas 1 tetor 2020 të pezullojnë pagesat e dividendit.

Që prej 31 mars 2020, Agjencia u bëri thirrje subjekteve të mbikëqyrura të pezullojnë pagimin e dividendëve si një masë parandaluese për të siguruar stabilitetin financiar gjatë epidemisë COVID-19. Kjo thirrje ishte në përputhje me Aktin e Sigurimeve si edhe Ligjin për Sistemin Financiar për Mbikëqyrjen Makroprudenciale. Thirrja përputhet edhe me standardet ndërkombëtare të sigurimit dhe udhëzimet e autoritetit evropian, EIOPA.

## Turqi

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas të dhënave nga Shoqata e Sigurimeve të Turqisë (TSB), gjatë gjysmës së parë të vitit 2020, tregu turk i sigurimeve realizoi një vëllim total prej 40.2 miliardë TRY (5.2 miliardë EUR). Kjo shifër paraqet një rritje prej 21% krahasuar me gjysmën e parë të vitit 2019. Sektori i sigurimeve të Jo-Jetës realizoi një vëllim prej 32.9 miliardë TRY (me rritje 14.9%) ndërsa sektori i sigurimit të Jetës realizoi një vëllim prej 7.3 miliardë TRY (duke shënuar rritje 59.3%). Ndërsa të shprehur në monedhën evropiane EUR sigurimet e Jo-Jetës u ulën me rreth 1.9% në terma vjetorë, ndërsa vëllimi i primeve të shkruara bruto në sektorin e Jetës u rrit me rreth 36.%.

MTPL ishte klasa që shënoi vëllimin më të madh të primeve të shkruara bruto në gjysmën e parë të vitit 2020, duke arritur në rreth 9.5 miliardë TRY. Pas saj renditet sigurimi shëndetësor me rreth 5.4 miliardë TRY, dhe në vend të tretë për rritje të primeve bruto ishte sigurimi i pronës nga zjarri dhe rreziqet e tjera që realizoi 4.9 miliardë TRY.



**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**

Për informacion të mëtejshëm  
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë  
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686  
[amf@amf.gov.al](mailto:amf@amf.gov.al) | [www.amf.gov.al](http://www.amf.gov.al)